



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Program i Integruar i Studimit “Master i Shkencave” në:
“Farmaci”
Universiteti “Aldent”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Kleva Shpati

Phd. Entela Hodaj

Prill / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Program i studimit i Integruar të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “Farmaci”

1	Universiteti “Aldent”	Universiteti “Aldent”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Farmacisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi i Integruar “Master i Shkencave” në “Farmaci”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr.519 datë 19.11.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr.353, datë 126.11.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 69 datë 04.10.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	300 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023	17 PAE / 20 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2018-2019 64 studentë; Viti akademik 2019-2020 51 studentë; Viti akademik 2020-2021 68 studentë; Viti akademik 2021-2022 89 studentë; Viti akademik 2022-2023 84 studentë;
19	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT

Universiteti Aldent u lincesua në bazë të VKM Nr. 673, datë 27.9.2006 “DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE “ALDENT” si shkollë e lartë universitare jopublike. Me VKM Nr. 539, date 13.06.2013 ndryshon statusi nga shkollë e lartë universitare private “Aldent” në universitet, me emërtimin Universiteti “Aldent”.

Universiteti “Aldent” ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik të zhvilluar nga ASCAL. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 01, datë 27.01.2023 “Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të Lartë Universiteti Aldent” me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 26.01.2028. Universiteti Aldent është i organizuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.80/2015 në tre njësi kryesore:

- Fakulteti i Shkencave Dentare;
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;

Programi i studimit i Integruar “Master i Shkencave” në “Farmaci” u lincesua me MASH Nr.519 datë 19.11.2010, me kohëzgjatje normale 5 vite akademike (300 kredite), në formën e studimit me kohë të plotë. Programi i studimit aktualisht ofrohet nga Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Programi i studimit është akredituar për herë të parë me Urdhër të MASH nr 248 datë 12.06.2013 dhe riakredituar me VBA Nr. 69 datë 04. 10.2019 me disa rekomandime.

Ky program është organizuar dhe strukturuar në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit, ligjin 80/2015 për “Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve ligjore në fuqi për IAL dhe i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), i organizuar me 300 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje 5 vite akademike.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në Kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit 2017”, Universiteti ALDENT, ka aplikuar nëpërmjet sistemit AMS, për nisjen e procesit të riakreditimit të programit të studimit të integruar Master i Shkencave në “Farmaci”. ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. As. Kleva Shpati dhe PhD.Entela Hodaj. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demimeli. Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci”, i ofruar nga Departamenti i Farmacisë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, filloi me prezantimin e grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ) dhe metodologjinë me të cilën do të realizohej procesi. GVJ bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

3

ASCAL, pasi shqyrtoi Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) si dhe të gjithë evidencat mbështetese përgatiti pyetjet dhe dokumentacionin shtesë të nevojshëm për vlerësimin në përputhje me standardet e cilësisë të ofrimit të programeve të studimit në fushën e arsimit të lartë.

Ky proces u pasua nga faza e vizitave dhe intervistave në institucion të GVJ, të cilat u realizuan në datën 22 dhe 23 Qershor 2023, në përputhje me axhendën e miratuar. GVJ realizoi një sërë takimesh gjatë vizitës në institucion, si me autoritetet drejtuese të UAL dhe FSHM, përfaqësues të organeve kolegjiale me stafin administrativ dhe fokus grupe të ndryshme të studenteve. Takimet dhe diskutimet iu mundësuan ekipit vlerësues të kuptojë qartë këndvështrimet e stafit dhe studentëve dhe dinamikën e zhvillimit të aktiviteteve akademike, administrative dhe kërkimore. Gjithashtu GVJ realizoi dhe një vizitë në ambjentet e brendshme të institucionit, që lidheshin kryesisht me programin e studimit, vizitoi klasat, laboratorët mësimorë, sekretarinë mësimore, bibliotekën, etj. Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, si dhe gjithë informacionin e mbledhur gjatë vizitës, GVJ arriti në konkluzionet të cilat janë dhënë në fushat përkatëse.

Universiteti "ALDENT", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 05.02.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 47 / 5 Prot, datë 05.02.2024, Universiteti "ALDENT", njofton në ASCAL më datë 14.02.2024, me anë të shkresës me Nr.6/3 Prot, datë 12.02.2024 "Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit".

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Për Komentin që i përket standardit II.1, kriteri 3:

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit të bërë, bazuar edhe në evidencën 29 të UAL, konkretisht vendimit 38 datë 20.11.2019, duke pasur jo karakter gjetjeje, por nxitje të përmirësimit dhe plotësimin e VKM 41 datë 24.01.2018. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

2. Për Komentin që i përket standardit II.2, kriteri 3:

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit të tij pasi koordinatori i programit, i cili është i parashtruar në rregulloren e programit (neni 13), duhet të paraqitet me dokumenta mbështetës nga ana e UAL duke reflektuar në përshkrimin e punës së koordinatorit konform kontratës së punës. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

3. Për Komentin që i përket standardit II.3, kriteri 4:

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit dhe plotësimin e programeve lëndore në përputhshmëri me VKM 41 datë 24.01.2018. **Raporti në këtë pikë ndryshon**

4. Për Komentin që i përket pjesës tek konkluzionet e standartit II.3;

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, dhe konstatoi se ngarkesa mësimore e lëndëve është kërkuar gjatë vizitës në institucion nga GVJ, dhe është ngarkuar në sistemin e ASCAL nga Institucioni. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

5. Për Komentin që i përket standardit II.4, kriteri 5;

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, ku konstatoi se të gjitha syllabuset e përditësuara dhe syllabuset përpara përditësimit, të cilat u kërkuar gjatë vizitës në institucion nga GVJ, janë ngarkuar në sistemin e ASCAL nga Institucioni. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

6. Për Komentin që i përket standardit III.3, kriteri 1;

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, ku konstatoi se në syllabuset e lëndëve janë paraqitur format e vlerësimit me pikëzim sipas komponentëve përbërës të vlerësimit përfundimtar. **Raporti në këtë pikë ndryshon.**

7. Për Komentin që i përket standardit VI.4, pjesa konkluzione;

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit të bërë, duke iu referuar shqyrtimit të dokumentacionit nuk rezultoi të pasyrohet roli i NJBSC në përditësimin e silabuseve dhe masat e veprimit të mara për ato raste kur evidentohen problem. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr 69 datë 04.11.2019 janë:

1. Institucioni, të rekutojë staf të ri akademik, me grada dhe tituj, me qëllim uljen e ngarkesës së lartë në një numër lëndësh të disa prej anëtarëve të stafit akademik aktual të angazhuar në këtë program studimi;
2. Institucioni, të rishikojë kategorizimin e lëndëve sipas veprimtarive formuese, në përputhje me VKM nr 41 datë 24.01.2018” për elementet e programeve të studimit të ofruara në institucionet e arsimit të lartë;
3. Institucioni të shtojë numrin e marrëveshjeve me insitucione të huaja të arsimit të lartë me qëllim përfitim të tyre të një numri sa më të madh studentësh dhe pedagogësh në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

GVJ referuar dokumentacionit, evidencave mbështetese si dhe informacionin dhe dokumentacionin e mbledhur gjate vizitave ne IAL konstatoi se :

Për rekomandimin e parë, gjatë periudhës 4 vjecare janë permiresuar politikat e rekrutimit dhe shperndarjes e ngarkesës mësimore në perputhje me dinamikën e zhvillimit te IAL-se si vijon:

- a) Ne lidhje shtimin e rekrutimeve te personelit akademik, UAL ka rekrutuar 13 personel akademik për këtë program studimi, nga të cilët 1 me titullin “Prof.As.”, 4 me gradën shkencore “Doktor”, 1 me ciklin e 3-te “SPA” dhe 4 me Msc.
- b) Ne lidhje me ngarkesen mësimore nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se gjatë periudhës 2020 – 2022, ngarkesa mesimore për këtë program studimi, eshte realizuar me mbi 70% nga stafi akademik efektive ne perputhje me VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.

Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht**

Për rekomandimin e dytë, Universiteti ALDENT e ka rishikuar kategorizimin e lëndëve sipas veprimtarive formuese dhe shperndarjen e tyre në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018. Ky rekomandim është **përmbushur pjesërisht** (6.6 % është shmangie nga 5%, por që asnje nga grupet e mëparshme nuk e kanë nxjerrë si problematike). Rekomandimi thotë të rishpërndahen lëndët sipas kategorive, por jo % e tyre.

Për rekomandimin e tretë, Universiteti “ALDENT” ka rritur numrin e marrëveshjeve te bashkëpunimit me insitucione të huaja të arsimit të lartë duke përfitur prej tyre si studentët edhe stafi akademik në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor por edhe integritimit te programve te ofruara ne perputhje me zonen evropiane te arsimit te larte. Për sa më sipër GVJ vlerëson se ky rekomandim është **përmbushur plotësisht**.

Vlerësimi i Programit të Integruar Master i Shkencave në «Farmaci»

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti ALDENT, ofron programe të licensuara nga Ministria e Arsimit, në përputhje me interesat kombëtare, të cilat synojnë aftësimin e studentëve dhe rritjen e mundësisë të punësimit të tyre në fushën e farmaceutikës, duke u siguruar studentëve një bazë të fortë teorike dhe praktike të shërbimit farmaceutik, dhe duke i përgaditur që të jenë të aftë të punojnë si në sektorin publik ashtu edhe atë privat, në Shqipëri apo jashtë saj. [Evd. 4, 5]
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i integruar i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci” është hartuar dhe ofruar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë, të paraqitura në aktet rregullatore të tij. [Evd. 4, 5]
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Programi i integruar i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” është hartuar në zbatim të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit. Rregulloret e Institucionit dhe Departamentit janë në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit. [Evd. 6.1. Evd. 6.2, Evd. 6.3]
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale	Programi i integruar i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” është zhvilluar në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, dhe prirjet globale të zhvillimit. Ky program është zhvilluar bazuar në Strategjinë Kombëtare dhe Sektoriale të Zhvillimit (Tetor 2022), Planin Kombëtar të Integrimin European 2022-2024 (9 Shkurt 2022), si dhe Planin European të Punës

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

7

të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	2020-2025, (8 Qershor 2021), Direktiva të BE për profesionet e rregulluara.			
Konkluzione	<i>Universiteti ALDENT (UAL) ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, të përshkruara në Statutin dhe Rregulloren e institucionit, si dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UAL, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																					
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>GVJ konstaton se UAL ka një historik të pasur dhe të larmishëm të aktiviteteve të tij akademike, mësimdhënëse dhe kërkuese të përshtatshme për ofrimin e një programi studimi të ciklit të dytë në Farmaci, nëpërmjet njësisë kryesore të tij Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 40 pedagogë, nga të cilët 21 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 19 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Shkencave Mjekësore</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td style="text-align: center;">1</td> <td style="text-align: center;">2</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td style="text-align: center;">4</td> <td style="text-align: center;">7</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td style="text-align: center;">9</td> <td style="text-align: center;">4</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td style="text-align: center;">7</td> <td style="text-align: center;">6</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td style="text-align: center;">21</td> <td style="text-align: center;">19</td> </tr> </tbody> </table>		Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjekësore		PAE	PAK	Prof.Dr	1	2	Prof.Asoc	4	7	Dr/PhD	9	4	Msc	7	6	Gjithsej	21	19
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjekësore																					
	PAE	PAK																				
Prof.Dr	1	2																				
Prof.Asoc	4	7																				
Dr/PhD	9	4																				
Msc	7	6																				
Gjithsej	21	19																				

	<p>Ndërsa Departamenti i Farmacisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023, ka këtë paraqitje:</p> <table border="1" data-bbox="587 347 1386 813"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Departamenti i Farmacisë</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>-</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>SPA</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>7</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table> <p>[Evd. 17., Tab.1, tab 2];</p>	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Farmacisë		PAE	PAK	Prof.Dr	-	1	Prof.Asoc	-	4	Dr/PhD	4	1	SPA	-	-	Msc	3	-	Gjithsej	7	6
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Farmacisë																							
	PAE	PAK																						
Prof.Dr	-	1																						
Prof.Asoc	-	4																						
Dr/PhD	4	1																						
SPA	-	-																						
Msc	3	-																						
Gjithsej	7	6																						
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Farmaci ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore, një nga njësitë kryesore të Universitetit ALDENT. Kjo njësi përbëhet nga 3 njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Farmacisë; 2. Departamenti i Formimit Mjekësor; 3. Qendra Kërkimore Farmako – Terapeutike; <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, në atë të shkencave mjekësore dhe më konkretisht farmaceutike. Programi është kodifikuar me FX bazuar sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e</p>																							
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Sipas organizimit të njësisë kryesore të UAL që është përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka tre njësi bazë ose departamente. Njësia bazë, e cila është përgjegjëse për programin e studimit, është Departamenti i Farmacisë dhe programi i ofruar i studimit është në përputhje me orientimin akademik dhe kërkimor të njësisë bazë, sic edhe paraqitet në rregulloren e njësisë kryesore. Ky program studimi nuk është ndërdisiplinor. [Evd. 6.2, 6.3]</p>																							




Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Sic GVJ u shpreh në kriteret 2 dhe 3 të kësaj fushe, Programi i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” është brenda profilit të institucionit.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Referuar RVB-së, UAL ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit, por këto nuk janë të mbështetura në evidencat përkatëse.			
Konkluzione	<i>UAL ka përvojën dhe kapacitetet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, në atë të shkencave mjekësore dhe më konkretisht farmaceutike. Për sa i përket trajnimeve profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit, nuk ka evidencat përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së	Nga analiza e përmbajtjes së RVB, GVJ konstatoi procedura të shkruara për ndarjen e detyrave mes njësisë përgjegjëse kryesore (FSHM) dhe asaj bazë (Departamenti i Farmacisë). Gjithashtu u konstatuan procedura të shkruara të ndarjes së përgjegjësive mes personelit të angazhuar për programin e studimit, qoftë akademik ashtu edhe jo akademik dhe administrativ. Institucioni ka hartuar rregullore të funksionimit të njësisë kryesore dhe bazë, ku

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

10




<p>detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>detajohet çdo aspekt i nevojshëm si detyra, role, funksione të personelit, përgjegjësitë e tyre, etj. Në <i>nenin 12</i> të Rregullores së FSHM, shihet gjithashtu se është bërë një parashikim i detajuar dhe i kujdesshëm i rolit të përgjegjësit të njësive bazë. Roli i koordinatorit të programit të studimit parashikohet në <i>nenin 13</i> të kësaj rregulloreje. [Evd.6.2, Evd 6.3]</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Realizimi i objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve realizohet në marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj, e mbështetur kjo edhe në evidencat përkatëse. Referuar dokumentacionit UAL ka listuar marrëveshje bashkëpunimi mes UAL dhe 177 farmaci të rrjetit të hapur, me Universita degli studi “G.D’Annunzio” Chieti, Pescara në Itali, në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve në implementimin e projekteve kërkimore të përbashkëta, me Universiteti I L’Aquila Italy, në kuadër të bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor dhe trajnimit e stafit akademik dhe studentëve, si dhe me Universitetin e Ankarasë, Ankara, Turqi, në kuadër të Programit Erasmus+ për shkëmbime studentësh dhe stafi per Fakultetin e Stomatologjise dhe Farmacinë. [Evd.17, Tab.5]</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentave dhe tabelave shoqëruese të RVB u has evidencë për marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme në favor të realizimit të praktikave profesionale në funksion të programit të studimit “Master i Shkencave në Farmaci”. Për realizimin e programit të studimit, Univeristeteti “ALDENT” ka nënshkrur marrëveshje të posaçme me QSUT, Urdhërin e Farmacistëve si dhe me farmaci të rrjetit të hapur për realizimin e praktikave profesionale duke bashkëpunuar me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjes së praktikës profesionale mësimore. GVJ vlerëson se këto marrëveshje krijojnë kushte të favorshme për kryerjen e praktikave të studentëve dhe kjo u konfirmua edhe nga studentët e programit gjatë vizitës në Institucion [Evd.17, Tab.5].</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia</p>	<p>Referuar RVB, Departamenti ka hartuar në mënyrë periodike raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e</p>

përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Zyra e marrëdhënies me jashtë është ajo që organizon dhe formalizon marrëveshjet e bashkëpunimit, dhe harton raporte periodike, me qëllim zbatimin sa me eficient të këtyre bashkëpunimeve. <i>Nuk u konstatua raport për vlerësimin analitik të këtyre bashkëpunimeve nga njësia kryesore.</i> [Evd.8,10]			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Universiteti "ALDENT" ka një strukturë të mirëorganizuar për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, duke mundësuar një ndarje të detyrave mes njësisë bazë dhe kryesore. Për realizimin e programit të studimit, Universiteti ALDENT, ka marrëveshje të posaçme me QSUT, Urdhërin e Farmacistëve si dhe me farmaci të rrjetit të hapur për realizimin e praktikave profesionale mësimore.</i> <u><i>Mungojne raportet për vlerësimin analitik të këtyre bashkëpunimeve nga njësia kryesore.</i></u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënljgore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në	Plani Mësimor i Programit të Studimit Msc në Farmaci, paraqet lëndët të ndara sipas veprimtarive formuese (A-E). Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi

<p>përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Lëndë Bazë, (A) “përgatitje metodologjike” dhe “kulturë e përgjithshme” 48 kredite – 16%, (standardi 15%-20%); - Lëndë Karakterizuese (B) përgatitje për disiplinën shkencore 157.5 kredite -52.55%, (standardi 50% - 55% (kredite); - Lëndë Ndërdisciplinore/ Integruese (C) nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje 44 kredite - 14.67%, (standardi 12% -15% kredite); - Lëndë Plotësuese (D) gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale 30.5 kredite - 10.18%, (standardi 10-15% (kredite); - Detyrime Përmbyllëse (E), 20 kredite, - 6.6%, (standardi 3%-5% kredite); <p><i>Rekomandohet rishpërndahen lëndët jo vetëm sipas kategorive, por edhe sipas % së tyre bazuar në VKM 41 datë 24.01.2018</i></p> <p>Evd.17, tab 10</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se rregullorja e programit të studimit Msc në Farmaci (<i>neni 2</i>) parashikon se ky program synon formimin e farmacistëve me standartet më të larta profesionale në shfrytëzim dhe shpërndarjen e informacionit bashkëkohor për barnat si dhe me aftësitë për tu përshtatur në sistemin shëndetsor gjithnjë në ndryshim. Objektiva të programit (sipas rregullores përkatëse) në përputhje me këtë mision të cilat duhet të zhvillojnë tek studentët: Programi i integruar i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci” realizon formimin e shprehive të veçanta në Farmaci, jep njohuri të përparuar në shkencat farmaceutike, ku përfshihet të kuptuarit kritik të parimeve akademike në shkencat farmaceutike duke zhvilluar njohuri, aftësi dhe kompetenca në këtë fushë, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri mbi farmaceutikën dhe kompetencë për të ushtruar profesionin e farmacistit në të gjithë sektorët e zakonshëm profesional; - Vlerat e nevojshme profesionale, që sigurojnë përkujdesje etike ndaj pacientit si individ, por edhe ndaj komunitetit që i shërbehet; - Aftësitë për të integruar kërkimin shkencor me eksperiencën praktike në dobi të nevojave të pacientit dhe shoqërisë;




	[Evd.3.0]
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Nga analiza e Planit Mësimor mund të konstatohet se në kurrikulën e Programit të Studimit Msc Farmaci janë përcaktuar ngarkesa në kredite, si edhe elementet e tjera (orët mësimore për leksionet, seminarët orët jashtë auditorit dhe aktivitete të tjera) për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Studentët e këtij program studimi i nënshtrohen praktikës profesionale e cila është realizuar me 25 kredite sipas planit mësimor e shtrirë në 10 javë, 400 orë në të cilat 160 orë semestri i parë (për 10 javë) dhe 240 orë semestri i dytë (për 15 javë).</p> <p><i>Ka një mospërputhje të deklaramit midis praktikës së kryer dhe asaj të deklaruar ku në total janë 25 javë praktikë profesionale dhe jo 10 javë.</i></p>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	[Evd.17]
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së	<p>Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi</p> <p>Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi</p>

paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Bazuar ne DVV, programi i integruar i studimit Mster i Shkencave “Farmaci” në UAL është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe, në dijeninë e GVJ-së, as programi i studimit dhe as Institucioni nuk gëzojnë status të vecantë.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Mbështetur në kurrikulën e programit, dhe në përmbajtjen e programeve lëndore të tij, GVJ shprehet se programi i integruar i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” që ofrohet nga Universiteti “ALDENT” krahasuar me programet e tjera në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, kanë të njëjtën përmbajtje të ngjashme në nivel, në masën më shumë se 70 %.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Sipas Rregullores së programit të studimit, ky program është program studimi i ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve organizohet me 300 ECTS dhe kohëzgjatje normale 5 (pesë) vite akademike me kohë të plotë, në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015. Programi i integruar i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci” nuk ka kodin përkatës sipas fushës së studimit, pasi mungon publikimi i tyre nga Ministria përgjegjese për arsimin.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit ofrohet nga vetë institucioni. Bazuar në deklaratimet e drejtuesve, në hartimin apo përmirësimin e vazhdueshëm të tij, ata bazohen në eksperiencat dhe praktikat më të mira brenda dhe jashtë vendit.




Konkluzione	<i>GVK konstatoi se në programi i studimit MSc në Farmaci organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare të ligjit për arsimin e lartë 80/2015, si dhe akteve të brendshme rregullatore të UAL, Statut, Rregullore etj. Rekomandohet të rishpërndahen lëndët jo vetëm sipas kategorive, por edhe sipas % së tyre bazuar në VKM 41 datë 24.01.2018.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2										
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.										
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve									
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Universiteti “ALDENT” përbëhet nga strukturat akademike dhe administrative, sipas organigramës. Autoritetet drejtuese janë, Rektori, Dekani, Drejtuesi i Departamentit, janë të shprehur Fakultetet por në organigramë nuk është përfshirë Dekani dhe Administratori. Organ drejtues është Senati Akademik.</p> <p>Universiteti ALDENT është i organizuar në 3 Fakultete:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore; 2. Fakulteti i shkencave Mjekësore Teknike; 3. Fakulteti i Shkencave Dentare; <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore përbehet nga 3 Departamente</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Farmacisë; 2. Departamenti i Formimit Mjekësor; 3. Qendër Kërkimore Farmako – Terapeutike; <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 40 pedagogë, nga të cilët 21 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 19 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Shkencave Mjekësore</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table>		Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjekësore		PAE	PAK	Prof.Dr	1	2
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjekësore									
	PAE	PAK								
Prof.Dr	1	2								

Prof.Asoc	4	7
Dr/PhD	9	4
Msc	7	6
Gjithsej	21	19

Departamenti i Farmacisë, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas tre viteve akademike që paraqiten si më poshtë vijon:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	1	-	1	-	1
Prof. Asoc.	-	3	-	3	-	4
Dr./PhD.	3	3	4	2	4	1
Msc.	4	-	3	-	3	-
Totali	7	7	7	6	7	6

[Evd.17, tab 1, 2]

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik/administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike. Referuar të dhënave rezultojnë se:

- për vitin akademik 2020-2021 Departamenti ka në përbërje 1 personel ndihmës akademik;
- Për vitin akademik 2021-2022 Departamenti ka në përbërje 1 personel ndihmës akademik;
- Për vitin akademik 2022-2023 Departamenti ka në përbërje 2 personel ndihmës akademik;

Evd.17, tab 2;

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një

Sipas *nenit 10*, të Rregullores së Fakultetit përcaktohet koordinatori i programit si autorite të tjera. Detyrat e koordinatorsit përcaktohen në *nenin 13* të kësaj rregulloreje konkretisht:

<p>person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ndihmon hartimin e kurikulave të disiplinave që mbulon; - Mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e caktuar; - Ndjek aktivitetin shkencor të anëtarëve të grupit, dhe informon autoritetet drejtuese; - Raporton tek përgjegjësi i departamentit për realizimin e programit mësimor në fund të çdo semestri; <p>Referuar RVB-së, Fakulteti ka caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë e zhvillimin e programit. Evd.6.2;</p> <p>Mungon koordinatori i programit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Sipas konstatimeve të GVJ, Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Departamenti i Farmacisë që janë njësitë përkatëse përgjegjëse për programin e studimit përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sa i përket organizimit dhe strukturës akademike, numrit të stafëve akademike efektive dhe me kontratë dhe në lidhje me vlerësimin dhe akreditimin. Koordinatori I programit duhet te jete emeruar si PAE në përputhje me vete rregulloren</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV GVJ konstatoi, dokumentat kryesore strategjike të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë që ofrojnë këtë program studimi (Rregullorja e Fakultetit; Rregullorja e Departamentit dhe Rregullorja e Programit të studimit) të cilat përmbajnë elementet e nevojshme në lidhje me programin si kohëzgjatjen e tij, organizimin në vite akademike dhe në semestra, në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e elementëve dhe lëndëve të programit.</p> <p>[Evd 6.2; Evd 6.3; Evd 3.0]</p>



<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i integruar i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” përmban planin mësimor i përbërë nga 300 ECTS, në të cilat 60 ECTS fitohen për cdo vit akademik, është përfshirë informacioni nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, por mungon ngarkesa mësimore të lëndëve/moduleve në 4 vitet akademike, orët në auditor/jashtë auditorit nuk përputhen. [Evd. 17, 10].</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i integruar i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci” përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studi [Evd. 12.1.1]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i integruar i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” në përgjithësi përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara nga aktet ligjore. [Evd 28]</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>GVJ konstatoi që përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim të vazhdueshëm, ku do të ishte e rëndësishme edhe përfshirja e kurrikulave për vitet 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022. [Evd 17, tab 10]</p>

Konkluzione	<i>Programi i studimit MSc Farmaci është strukturuar dhe organizuar në përputhje me VKM 41, e ndryshuar duke marrë në konsiderate ndarjen e veprimtarive nga A-E, organizimin e syllabuseve sipas formatit të propozuar etj. Përditësimet e programit bëhen në mënyrë të vazhdueshme dhe dokumentohen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ konstatoi se programi i studimit MSc Farmaci është strukturuar dhe organizuar në përputhje me VKM 41, e ndryshuar duke marrë në konsiderate ndarjen e veprimtarive nga A-E praktika mësimore është pjesë e rëndësishme e kurrikulës së programit e cila rrit aftësitë e studentëve dhe thellimin e njohurive.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Në programin e integruar të studimit Master i Shkencave në “Farmaci” lëndët/modulet janë të shpërndara në 60 ECTS për 5 vite akademike me një total prej 300 ECTS të fituara. Lëndët me zgjedhje dhe të moduluara me numër kreditesh te vogla rrisin rezultatet e të nxënit. [Evd 17, tab10].
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të	GVJ konstatoi se struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit [Evd. 17 tab. 13]. <i>Mungon evidenca qe provon ngjashmërinë me programet ndërkombëtare.</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

20


<p>ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në programin e integruar të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci”, ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik krijojnë mundësinë e mobilitetit të studentëve, duke mundësuar arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve. GVJ konstatoi që për këtë kriter grupi i punës nuk ka përfshirë asnjë evidencë mbështetëse duke pohuar vetëm kriterin.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ konstatoi se syllabuset e lëndëve përditësohen çdo vit në fillim të tij, duke vendosur në korrespondencë të çdo leksioni literaturën respektive të detyrueshme. Në çdo fillim viti akademik pasi rishikohen duke ju referuar udhëzimeve e normativave ligjore në fuqi, syllabuset dorëzohen dhe arkivohen pranë departamentit, të firmosura nga titullari i lëndës. <i>Megjithatë nuk u konstatua evidencë</i> sesi është realizuar kjo procedure në përputhje me tregun e punës dhe literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar.</p> <p>[Evd. 28].</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Në programin e integruar të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci”, GVJ konstatoi se përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ konstatoi se në programin e integruar të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci”, përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve bazuar në të dhënat sipas Alumnit [Evd. 7]</p>

Konkluzione	<p><i>Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</i></p> <p><i>Megjithatë nuk u konstatua evidencë sesi bëhej përditësimi i syllabuseve në përputhje me tregun e punës dhe literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>UAL ne programin programin e integruar të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci” ka përmirësuar përmbajtjen e programit duke marrë në konsideratë studimin e tregut të punës, me kërkesat e tij, me institucionet partnere [Evd. 28].</p> <p>Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës është e nevojshme hartimi dhe studimi i të tregut të punës, i cili mungon dhe nuk është bashkengjitur në evidencat.</p>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në	<p>Studentët janë të përfshirë në disa organe të institucionit si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Këshilli i Studentëve, NJSBC, dhe në këto struktura tërhiqet mendimi i drejtpërdrejtë i tyre. Institucioni tërheq mendimet e studentëve në fund të semestrave në lidhje me lëndët dhe aspekte të mësimin me anë të një pyetësi anonim, ku studentët shprehin opinionin e tyre.</p> <p>Institucioni mban lidhje të vazhdueshme me studentët e diplomuar, prej të cilëve merr informacion në lidhje me</p>

ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	punësimin e tyre, kërkesat e tregut të punës duke mundësuar edhe të kuptuarit e nevojës për ndryshim të programit. [Evd, 4, 12.5, 21.3]			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Në programin e integruar të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci” në UAL, njësia bazë ka përmirësuar programin me zhvillimet bashkëkohore në fushën përkatëse atë, farmaceutike si dhe ka një bashkëpunim me Urdhërin e Farmacistëve të Shqipërisë, si pjesëmarës në veprimtari të përbëshkëta dhe aktivitete shkencore si konferenca etj. [Evd. 12]			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se ky standart përmbushet plotësisht. Njësia bazë ka përmirësuar përmbajtjen e programit të studimit duke e hartuar atë në përputhje me tregun e punës si dhe duke bashkëpunuar më Urdhërin e farmacistëve të shqipërisë për veprimtari të ndryshme të përbashkëta.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Në UAL, programi i integruar i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci” ka të përcaktuara qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit të cilat janë përputhje me objektivat madhorë të Institucionit [Evd.4] , si dhe rritja dhe zhvillimi i kërkimit shkencor në përputhje me rregulloren e programit të studimit [Evd.3]
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit,	Njësia bazë, në UAL bashkërendon dhe administron procesin akademik bazuar në lirinë akademike të stafit që shprehet në

bashkërendon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	tematikat e lëndëve, literaturën e përzgjedhur si dhe mënyrën e organizimit të mësimdhënies me modulet përkatëse. Shpërndarja e orëve misioni atyre teorike dhe laboratorike bën të mundur fitimin e kompetencave të shprehura në syllabus.			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Departamenti në programin e integruar të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci ka mundësuar dhe motivuar studentët të angazhohen rritjen dhe thellimin e njohurive në lëndët formuese dhe karakterizuese në shkencat farmaceutike nëpërmjet projekteve, detyrave të kurseve për lëndë të ndryshme, në përgatitjen e temave të diplomës, të cilat janë kërkimore - shkencore (laboratorike) dhe rishikime të përditësuara të literaturës në një fushë të caktuar (review). Studentët janë pjesëmarrës aktivë në aktivitetet dhe veprimtari kërkimore shkencore të organizuar nga universiteti dhe nga institucione të tjera [Evd.13, 31.2].			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Në programin e integruar të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci” studentët janë motivuar edhe angazhuar në përgatitjen e temave të diplomës dhe në aktivitete kërkimore duke patur edhe mbështetjen financiare të Institucionit [Evd.14]			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se ky standart përmbushet plotësisht, duke mundësuar që programi i integruar i studimit Master i Shkencave në “Farmaci” është në përputhje me intereset dhe objektivat e Institucionit duke mundësuar motivimin e studentëve në përgatitjen e temave të diplomës, nxitjen e kërkimit shkencor dhe në aktiviteteve kërkimore-shkencore duke patur edhe mbështetjen financiare të Institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Konstatohet se aktiviteti kërkimor zhvillohet edhe në bashkëpunim me institucione dhe partnerë të jashtëm të institucionit. Departamentet dhe njësitë kërkimore brenda universitetit, si Qendra farmako - terapeutike, kanë në fokus realizimin e studimeve, analizave, projekteve, në bashkëpunim me partnerët jashtë institucionit. Kjo qendër mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja duke siguruar bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. [Evd.10]
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	GVJ konstatoi se njësia bazë ju është përgjigjur kërkesave me karakter kërkimor shkencor. Në dispozicionin të punës kërkimore në UAL në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik janë në dispozicion laboratorët përkatës sipas fushave të pajisura me pajisje dhe materiale didaktike për realizimin e objektivave të tyre [Evd.15.1]
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Njësia bazë ka organizuar konferencën e përvitshme studentore si dhe aktivitetet Einter School dhe Summer School të cilat kanë qenë pjesë e rritjes së performancës së stafit akademik dhe realizimin e objektivave kërkimore shkencore të studentëve [Evd. 16].
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	GVJ konstatoi që në programin e studimit master i shkencave në Farmaci pranë UAL ka një ndërthurje të lëndëve formuese dhe karakterizuese me praktikën profesionale mësimore dhe punën kërkimore shkencore duke pajisur studentët me njohuri të thelluara, të aftë profesionalisht për tu përballur me tregun kombëtar dhe e më gjerë [Evd. 28]
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh	Në UAL njësia bazë ka marrëdhënie bashkëpunimi me Urdhërin e Farmacitëve të Shqipërisë, e cila reflektohet edhe aktivitetet e

dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	përbashkëta me pjesëmarrje aktive. UAL është gjithmonë në njohje të situatës rreth rezultateve të studentëve të cilët përmbushin detyrimet pas diplomat si “Provimi i ushtrimit të profesionit”, duke vlerësuar rezultatet për të përmirësuar kurrikulën dhe praktikën profesionale për rezultate sa më optimale. [Evd. 7.1]			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Në programin e integruar të studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci në UAL u konstatua që ky program është hartuar në përputhje me aktet ligjore në vend si: <ol style="list-style-type: none"> 1. Ligj nr. 80/2015 “ Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” 2. Ligj Nr 05L/066 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë. 3. Directive 2013/55/EU e European parliament of the Council of 20 November 2013 amending Directive 2005/36/EC on the recognition of professional qualifications and Regulation (EU) No 1024/2012 on administrative cooperation through the Internal Market Information System (‘the IMI Regulation’) 4. Directive 2005/36/EC of the European Parliament and of the Council of 7 September 2005 on the recognition of professional qualifications (Text ëith EEA relevance) 5. ECTS users' guide 2015 			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se ky standart përmbushet plotësisht pasi UAL ushtron veprimtarinë e tij për zbatimin e programit Master i Shkencave në «Farmaci» në përputhje me aktet ligjore në vend dhe ato ndërkombëtare. Ky program garanton nëpërmjet tij studentë të kualifikuar për shërbimin farmaceutik në vend dhe atë të huaj</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: “Rruga e Durrësit”

E-mail: info@ascal.al

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

web site: www.ascal.al


26

				X
--	--	--	--	---

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ konstatoi se në UAL, në programin e integruar Master i Shkencave në “Farmaci” zbatohen format e mësimdhënie dhe mësimnxënie ku ka një ndërthurje të pjesës teorike me atë praktike, ndërthurje të punës eksperimentale me kompetencat e fituara. Detyrat e kursit, projektet kanë nxitur punën në grup, rritjen e të shprehurit dhe argumentimin shkencor.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Në programin e intergruar Master i Shkencave ne “Farmaci” ushtrojnë veprimtarinë e tyre akademike personel akademik efektiv me shumë vite eksperiencë dhe personell i kualifikuar me kontratë në fushat përkatëse të mësimdhënies. Eksperiencia e tyre ofron cilësi në mësidhënie me metoda të shumta alternative në strukturimin e mesimdhënies dhe mësimnxënies. Personeli akademik i njësisë bazë ofron forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet provimeve të cilat përdorin një metodikë me pyetje të hapura dhe me alternativa. Gjatë takimit me studentët u konfirmua që tutoriati dhe marëdhëniet e stafit me studentët ka ndihmuar në përmirësimin e metodave interaktive të mësimin [Evd.19].
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	UAL ka mbështetur personelin akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike në mësimdhënie. Të gjitha sallat ishin te pajisura me pajisjet e nevojshme, internet pa limit, që mundëson dhënie e leksioneve. Në UAL platforma elektronike e mësimin në distancë “eLearning” përdoret edhe pas periudhës Covid-19, e cila është përdorur edhe përdoret maksimalisht për rritjen e kompetencave të studentëve dhe

	<p>mësimdhënies. Në këtë platformë jepen informacione të literaturës së rekomanduar, informacione shkencore, video praktike të cilat përdoren nga studentët për përmirësim të dijeve teorike dhe praktike. [Evd. 20, Platforma online ual.iqe.al].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion dhe në takimin me personelin akademik u konfirmua edhe sipas RVB se PAE dhe PAK në këtë program ka një experience të gjatë me ekspertizën e gjithësecilit për lëndët formuese dhe karakterizuese duke mundësuar fitimin e kompetencave nga ana e studentëve. Leksionet, punët laboratorike dhe praktike organizohen në grupe të vogla, ku rruajtja e cilësisë dhe puna në grup shërbejnë për nxitjen e mësimnxënies. Respektimi i fushës së ekspertizës së çdonjërit personel akademik me lëndën të cilën ai zhvillon rrit cilësisht procesin e mësimdhënies duke përmirësuar ndjeshëm atë të mësimnxënies. Respektimi i fushës së ekspertizës do të çojë në përmirësim të procesit të mësimdhënies</p> <p>Gjatë takimit u konstatua se metoda interaktive, ndërthurja e pjesës teorike dhe praktike, video demonstrative didaktike nxisin tek studentët mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. [Evd.15, 25.2]</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Njësia bazë në UAL vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces, si pyetjet direkte dhe indirekte gjatë procesit mësimor, vlerësime të tyre gjatë tutoriatit si dhe pyetsorin e studentëve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Gjatë vizitës në institucion u konstatua që pyetsori të cilin ata e plotësonin si dhe sugjerimet e tyre gjenin zbatim me qëllim përmirësimin e performancës. Gjatë takimit u konfirmua që pyetsori i studentëve ishte kriteri i vetëm i vlerësimit të performancës së stafit nga njësia bazë. [Evd. 21.3].</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me</p>	<p>GJV konstatoi se Njësia e Sigurimit të Kontrollit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e ushtron veprimtarinë e tij në nivel insitucional, e cila është strukturë përgjegjëse për vlerësimin, monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kjo strukturë ishte e pavarur nga strukturat akademike dhe koordinonte dhe bashkërendonte me njësinë kryesore aktivitetet në kuadër të përmirësimit të</p>



<p>njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>cilësisë së mësimdhënies me stafin. Gjatë takimit u pohua se strukturat mbështesin zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, ato trainonin vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. NJSBC në UAL ka organizuar aktivitete të mësimdhënies me personelin akademik duke argumentuar teknikat e mësimdhënies me modelet më të mira. [Evd. 19]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se ky standart përmbushet plotësisht. Në UAL format e mësimdhënies, mësimxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, projektet, praktikat profesionale etj. Universiteti ALDENT ka të organizuar në nivel institucional NJSBC që promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinon dhe bashkërendon me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies aktivitete të ndryshme.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të</p>	<p>Bazuar ne DVV, GVJ konstatoi se njësia bazë, në programi i integruar i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci ushtron veprimtarinë e saj duke përcaktuar kriteret të qarta për provimin si dhe procedure perkatëse. Mënyra testimit vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore bazohej në Rregulloren e Programit të Studimit dhe procedurave perkatëse te cilat u konfirmuan edhe gjatë takimeve ne institucion.[Evd. 3, 12.1]</p>



posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.									
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar ne DVV, gjatë vizitës takimi me studentët GVJ konstatoi se Departamenti ndiqte një procedurë informuese për studentët duke i informuar për veprimtaritë duke në fillim të çdo lënde/moduli me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit dhe lektorët. [Evd. 17, Tab. 14]								
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Departamenti, në programi i integruar i studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci ka realizuar testimin e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore bazuar në Rregulloren e Departamentit. Po sipas kësaj rreguloreje testimi realizohej në tre forma të të shprehurit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provim me shkrim; 2. Provim me gojë; 3. Provim me shkrim dhe me gojë; <p>Nuk kishte të shprehur se clat lëndë i nënshtoheshin specifikisht kësaj mënyrë të të pyeturit të dosjeve, por vendosj nga titullari i lëndës duke rspektuar lirinë akademike. Teza miratohej nga drejtuesi i Departamenti i përgatitur prej Titullarit/Lektorit të lëndës. Vlerësimi i dijeve përfundimtar bazohej edhe në elemente të tjerë vlerësues, si detyra kursi, projekte kolokiumeve, praktikave mësimore të cilat i bashkengjëtishin provimit përfundimtar.</p>								
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se programi i integruar i studimit Master i Shkencave në “Farmaci të UAL, njësia bazë ushtron veprimtarinë e saj duke përcaktuar kriteret dhe mënyra testimi, bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit dhe procedurave specifike. Në Rregulloren e Departamentit është përcaktuar forma dhe mënyra e testimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Gjatë takimeve në UAL, njësi bazë organizon testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të gjatë gjithë vitit akademik, e cila është reflektuar në vlerësimin përfundimtar, bazuar në rregulloren e Programit të studimit të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin formën e ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Bazuar në DVV, GVJ konstatoi se forma e kontrollit të dijeve në programin e studimit të shkencave në Farmaci në UAL realizohej me shkrim, me alternativa dhe pyetje të hapura. Forma e kontrollit të dijeve elektronike për të shmangur format e abuzivizmit dhe rritjen e transparencës realizohej për disa lëndë si statistikë, informatikë, psikologji etj. Kjo formë e vlerësimit nuk ishte përdorur për lëndët e tjera ndaj zbatimi i sistemeve elektronike të vlerësimit mund të zbatohen edhe për lëndë të tjera.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ konstatoi se vlerësimi përfundimtar bëhej në përputhje me syllabusin e lëndës, duke respektuar shprehjet e pikëve dhe rregulloren në programin e studimit. Në DVV megjithëse janë shprehur më sipër evidencat nuk janë bashkëngjitur për këtë kriter.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Gjatë vizitës në Institucion GVJ konstatoi se vlerësimi i dijeve shoqërohej me komente të shkruara qartë dhe të kuptueshme për studentin. Në programin e integruar të studimit <i>Master i Shkencave</i> në "Farmaci", vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente verbale nga ana e pedagogëve të cilat ishin në shërbim të studentit për të ndihmuar atë të përmirësohet në të ardhmen. [Evd. 17, 14]
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë	Në DVV GVJ konstatoi që njësi bazë në bashkëpunim me personelin akademik organizon provimin duke shmangur kopjimin duke respektuar distancën, moslejimin e mjeteve të

plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	komunikimit dhe mbikëqija e provimit realizohej me të paktën 2 pedagogë. Bazuar ne DVV nuk jepen metoda dhe mënyra për shmangien dhe kontrollin e plagjaturës për temat e diplomës dhe detyrat			
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në DVV, rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen brenda 7 ditëve, dhe prezantohen në menyre individuale studentëve nga komisioni i provimit. Pasi studentët janë njohur me rezultatin hidhen në systemin on linë nga semretaria mësimore. [Evd. 12.1, 12.2]			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Bazuar në DVV, studentët kanë të drejtë të njihen me vlerësimin, të kontestojnë dhe të kërkojnë rivlerësim bazuar sipas me një kërkesë me shkrim. Drejtuesi i njësisë bazë pasi shqyrton ankesën rimerr studentin në provim, me një komision të posaçëm të ngritur me propozimin e tij.			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në DVV shkrehet qartë që Departamenti merr në kosideratë çdo kërkesë, dhe komisioni i posaçëm i ngritur prej tij ushtron veprimtarinë sipas njëj procedure transparente dhe të dokumentuar.			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se në programin e integruar të studimit Master i Shkencave në "Farmaci", njësia bazë mbikëqyr testimin dhe vlerësimi e njohurive, dijeve gjatë gjithë vitit akademik e cila është reflektuar në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit Departamenti vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe me shkrim. Departamenti shmang kopjimin dhe nuk lejon plagjaturën, megjithese nuk është shprehur në asnje evidence sesi kontrollohet plagjatura.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Në programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci”, garaton thellimin e njohurive, dukem zhvilluar aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve të farmacisë
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Në programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Farmaci”, garantohen zhvillimet e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, përfshirë edhe gjuhën angleze.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në këtë program studimi kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. [Evd. 28]
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet	Në programin e studimit mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara duke ndërthur format e mësimdhënies me institucionet

<p>diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve [Evd. 8]</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti nëpërmjet personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. [Evd. 18]</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>UAL nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato si në aktivitet të organizuara nga Urdheri i Farmacistëve të Shqipërisë dhe Universiteti i Mjekësisë së Tiranës.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në programin e studimit Master i Shkencave në "Farmaci", në UAL garatohet thellimi i njohurive, duke zhvilluar aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve të farmacisë si dhe zhvillimet e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, përfshirë edhe gjuhën angleze.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.5



Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	UAL ka një procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, e cila është shprehur në punimin e temës së diplomës me një procedurë të qartë diplomimi. Në këtë procedurë janë të shprehura qartë, karakteri i temës së përzgjedhur, udhëheqësit të caktuar paraprakisht në mbledhje Departamenti, ndjekja e gjithë procesit të përgatitjes së temës nga ana e udhëheqësve, ngritja e komisionit të vlerësimit dhe vlerësimi i temave. [Evd. 31.3]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Bazuar në DVV, si dhe gjatë takimeve në UAL, departamenti dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime. Në rastet kur tema e diplomës është eksperimentale, pjesa praktike realizohet në ambientet e UAL ku studentëve ju vihen në dispozicion materialet dhe reagentët të ndryshëm për realizimin e temës. Studentët kanë në dispozicion bibliotekën on line "Hinari", e cila mund të përdoret nga studentët për pjesën teorike të hulumtimit. Gjithë procesi i përgatitjes së temës së diplomimit është aktiv në kontakt fizik ose virtual me pedagogun udhëheqës deri në fund të detyrimeve përmbyllëse [Evd 31.2]
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	GVJ gjatë takimeve konstatoi se vlerësimi i temave të diplomës bazohet në: a) mënyrën e prezantimit, b) në mënyrën e shkrimit të temës të paraqitur në hardcopy, c) në vlerësimin e komisionit si dhe d) rezultatet e të nxëniet për gjatë viteve akademike në bazuar në rëndësinë dhe peshën specifike të tyre.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e	Në Departamentin e Farmacisë, në UAL, personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Pedagogët realizojnë takime paraprake duke diskutime rreth mundësive të temave të përzgjedhura. Dhe më pas në vendosjen e temës së hulumtimit. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas rregullores së temave të diplomës. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

35

<p>rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit, vlerësimi i të cilit është pjesë e procedurës së diplomimit. [Evd. 31.3]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Referuar DVV, Departamenti asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së ekspertizës së pedagogut udhëheqës. [Evd 25.2, 30]</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ konstatoi se në përfundim të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me note, ku dorëzon pranë komisionit prezantimin në PPT dhe hardcopy, Rezultati I vlerësimi të diplomimit është shprehur qartë në procesverbalet e diplomimit.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar [Evd 31.1]</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>GVJ konstatoi se njësisia bazë në UAL, ruan temat e diplomës në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. Në UAL forma dhe përmbajtja e dokumentit të diplomës i përmbahet Udhezimit 10 datë 30.03.2020 'Për përcaktimin e elementëve, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucioni i Arsimit të Lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për Arsimin e Lartë dhe</p>

	Kërkimin Shkencor” si dhe Udhëzimin 11 datë 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së suplementit të diplomës” [Evd 31.1]			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se në UAL ka një procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, bazuar në aktet ligjore në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe	Ky kriter nuk është i vlefshëm për këtë program studimi

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

37

stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione	<i>Ky kriter nuk eshte vlefshëm per këtë program studimi</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë	Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton që personeli akademik i angazhuar për tre vite akademike është si më poshtë: 1. Për vitin akademik 2020-2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 36 pedagogë nga të cilët 16 PAE dhe 20 PAK (44.4% /55.6 %); 2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 34 pedagogë nga të cilët 17 PAE dhe 17 PAK (50 % /50 %);

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

38

kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 37 pedagogë nga të cilët 17 PAE dhe 20 PAK (45 % / 55 %);

Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	1	2	1	2	1	2
Prof.As.Dr	3	6	5	8	6	7
Dr/PhD	7	9	7	7	6	6
SPA	-	1	1	-	-	2
Msc	5	2	3	-	4	3
Në total	16	20	17	17	17	20

Sipas përcaktimeve ligjore (pika 6 neni 59 i Ligjit Nr 80/2015), personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës, nga sa më sipër konstatohet se në këtë program studimi angazhohen edhe staf akademik me Msc (përqindje e vogël, 9 – 18 %, sipas viteve), në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

GVJ rekomandon të meren masat e nevojshme për të mundësuar që personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në realizimin e programit të studimit të ketë të paktën gradën shkencore Dr., në mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik.

[Evd 17, tab 6.1-6.3]


Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Numri dhe raporti i orëve mësimore të realizuara nga stafet akademike PAE / PAK në tre vitet e fundit akademike (sipas dok të kërkuar gjatë vizitës në institucion [Ngarkesa PAE, PAK ne %] jepet në vijim:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2020-2021	5318	3813	1505	71.69% /28.31%
2021-2022	5040	3635	1405	72.12% /27.88%
2022-2023	5198	3621	1577	69.7% / 30.3%


	<p>Nga tabela rezulton që për tre vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me <u>mbi</u> 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>UAL paraqitet si një IAL konkures i cili ndjek politika të investimit dhe përkrahjes të stafik akademik duke siguruar qëndrueshmëri të personelit dhe garanci të suksesit të programit. Punësimi i personelit në Aldent respekton kërkesat e Kodit të Punës, me kontrata individuale punësimi dhe mbulimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore [Evd. 116].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Kërkesa për rekurrim staf akademik dhe jo akademik bëhet nga njësia bazë, departamenti, e argumentuar me nevojat dhe specifikimet për profilin e kandidatëve. ALDENT në përputhje me afatet kohore ngre komisionet ad-hoc të vlerësimit me 5 anëtarë nga të cilët 3 janë përfaqësues të Departamentit përkatës, një përfaqësues i Dekanatit dhe një përfaqësues i Rektoratit. Komisioni bën vlerësimin e aplikantëve në përputhje me kriteret e shpallura, shqyrton dosjen e aplikimit sipas formularit të vlerësimit dhe harton listën e kandidaturave, sipas pikëve të grumbulluara, në rendin zbritës për çdo kandidat së bashku me pikët e intervistës. Kandidatët njoftohen nga NJSBC me email për pikët e grumbulluara dhe rankimin e tyre. Shpallet lista përfundimtare e kandidatëve fitues nga Dekani, i cili përcjell tek Rektori emrat fitues, së bashku me renditjen e tyre. [Evd. 22.1, 22.4]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për</p>	<p>UAL garanton mbarëvajtjen e praktikave mësimore (laboratore) në ambiente adekuate dhe me personelin e duhur akademik dhe ndihmës akademik. Departamenti i farmacisë ka në përdorim gjashtë laboratorë mësimorë të cilat mirëmbahen nga stafi ndihmës akademik [Evd. 25].</p>

<p>mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>IAL përditëson çdo vit të dhënat e personelit akademik, ndihmës dhe administrative. Zyra e burimeve njerëzore disponon të përditësuar listën e plotë të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ dhe dosjet e plota të tyre. Sipas verifikimeve gjatë vizitës zyra e Burimeve njerëzore përditëson të dhënat e personelit akademik për rritjen e tyre akademike, në dosjen personale dhe në faqen e internetit të UAL. Përditësimi realizohej edhe në CV e personelit akademik. [Evd. 22.5].</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në marrëveshjet që ALDENT ka me IAL të tjera publike dhe private por edhe biznese si farmaci të rritit të hapur, vendos në dispozicion stafin e mjaftueshëm për të udhëhequr dhe mbikëqyrur praktikën profesionale (sipas librit të praktikës profesionale të studentit). Punimi i diplomave është një kombinim i nevojave të sektorit për studime specifike dhe bashkë propozimeve student-pedagog.</p> <p><i>GVJ konstaton si mangësi të këtij programi, mungesën e aplikimeve për projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare, me partner vendas dhe të huaj me baze eksperimentale.</i></p> <p>[Evd. 11]</p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të</p>	<p>Bazuar në DVV, personeli mbikëqyrës në farmacinë pritëse, drejtues Teknik i Farmacisë, angazhohet dhe kontribuon në mënyrë aktive në aftësimin e studentit praktikant, ndihmon në plotësimin e librezës personale të praktikës mësimore të studentit si një raport përfundimtar i firmosur nga drejtuesi teknik, e cila përbën dokumentin bazë që konfirmon kryerjen e</p>



ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	praktikës profesionale mësimore. Praktika profesionale vlerësohet me notë nga komisioni i provimit [Evd. 11.1].			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se numri dhe raporti i orëve mësimore të realizuara nga stafet akademike PAE / PAK në tre vitet e fundit akademike janë në përputhje me standardin, Në UAL praktika e rekrutimit të stafit mbikëqyret nga njësia bazë, dosjet e personelit akademik janë të përditësuara dhe të ruajtura pranë zyrës së Burimeve njerëzore. GVJ konstatoi mungesën e aplikimeve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare me partner vendas dhe të huaj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimorë, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë, si edhe hapësirë të jashtme në ambiente të tjera dhe parking. Institucioni disponon sistem ngrohje-ftohje qendrore, sistem sigurimi pa ndërprerje të energjisë elektrike, nyje hidrosanitare, sistem të mbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve, të cilat u verifikuan dhe gjatë vizitës në institucion. Janë dispozicion të procesit mësimor sipërfaqe rreth 8700m ² . Ambientet janë të reja të konceptuara sipas nevojave të vërteta të një kampusi universitar. Mjediset janë ekskluzivisht të dedikuara aktiviteteve specifike [Evd. 15.2].



<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Ambientet e fakulteteve (salla leksionesh e seminaresh, laboratorë didaktikë mësimorë) janë të përshtatshme dhe komode për zhvillimin e aktivitetit mësimor e kërkimor-shkencor për studentët dhe personelin akademik. Sipërfaqet në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve për kryerjen e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, janë në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. [Evd. 15.2].</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në nivel programi studimi të gjithë laboratorët ku zhvillohen orët laboratorike janë të pajisur dhe plotësuar me mjete mësimore, aparatura dhe reagentë në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit [Evd. 15.1].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>UAL ka një laborator të informatikës të pajisur me kompjutera dhe akses në programe dhe databaza specifike si të statistikës SPSS dhe kërkimit të literaturës në dispozicion të studentëve dhe stafit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet</p>	<p>Duke u bazuar në evidencat të vendosura në dispozicion dhe vizitën fizike në IAL, GVJ konkludon se mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Rregullore e sigurisë në laborator është e plotë dhe udhërrëfyese për cdokënd që ka akses në laborator [Evd. 6.6].</p>

<p>marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi që UAL ka siguruar ambiente të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në përputhje me numrin e grupeve por edhe me natyrën specifike të lëndëve. Ambientet si salla leksionesh, seminare, laboratore janë në kushte komode dhe me parametrat e nevojshme të cilësisë për realizimin e të gjitha llojeve të veprimtarive.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe gjatë vizitës u konstatua se literatura bazë dhe ajo mbështetëse ishte në formën hard copy dhe dixhitale duke garantuar mbarëvajtjen e programit të studimit për literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar. Në bibliotekën e Aldent ndodhen rreth 700 tituj librash profesionale në dispozicion të programit të studimit farmaci si dhe biblioteka dixhitale “Hinari”, e pajisur me tituj të shkencave mjekësore dhe ato farmaceutike. GVJ konstatoi se literatura e detyruar nuk ishte brenda 5 viteve te fundit. [Evd. 23].</p>



<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në DVV njësia bazë paraqesin kërkesa për përditësimet të literaturës. IAL parashikon një buxhet të caktuar për blerjen e librave dhe pasurimin e bibliotekës.</p> <p><i>GVJ konstaton se përditësimet në literaturë nuk rezultojnë të jenë të realizuara për gjithë lëndët e programit të farmacisë. Të gjithë studentet kanë akses të plotë në bibliotekën online sikurse ato fizike.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe gjatë vizitës u konstatua se biblioteka ishte e pajisur me libra dhe tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe atë të huaj. Ajo kishte 60 vende të shfrytëzueshme dhe studentët kishin akses edhe në bibliotekën online. "Hinari"</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Shfrytëzimi i bibliotekës fizike dhe online është i garantuar në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë për gjithë studentët dhe stafin. <i>GVJ sugjeron se biblioteka duhet të ofroj orare ekstra gjatë kohës së sezonëve të provimeve sikurse edhe në fundjava.</i></p> <p>[Evd. 23].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës u konstatua se biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike të aksesueshme nga studentet dhe stafi. Akses i plotë në bibliotekën online Hinari është i mundur për gjithë studentet pa limit kohe.</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe gjatë vizitës u pa se orari i shërbimit të bibliotekës është i kufizuar vetëm në orët e procesit mësimorë,</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi</p>	

<p>që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ sugjeron që aksesit në fundjavë dhe orare të zgjatura gjatë sezonit të provimeve duhet të sigurohet në vazhdim.</p>			
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Departamenti ndjek cilësinë e programit fizik të bibliotekës fizike dhe asaj online, përditësimin dhe shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe online nga personeli akademik dhe studentët dhe mat efektivitetin dhe nevojën e pasurimit të vazhdueshëm të fondit me sugjerime të stafit akademik por edhe studentëve për nevoja që ato kanë për literaturë. Drejtuesit e njësive bazë por edhe të Fakultetit gjatë intervistave specifikuan se investimi në literaturë lidhet drejtëpërdrejtë me performancën dhe reputacionin e ndërtuar të Aldent. [Evd 23]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ eidenton se programi i studimit Msc në Farmaci përmban literaturën e nevojshme në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset e posaçme). Literatura bazë dhe ajo mbështetëse qoftë fizike dhe ajo digjitale janë të garantuara për mbarëvajtjen e programit të studimit. Me shume vemendje duhet dedikuar përditësimin të literaturës, e cila duhet të realizohet nga titullarët e lëndëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Stafi dhe studentët në Aldent janë të pajisur me adresa elektronike të aksesueshme në cdo aparat kompjuterik dhe telefon kudo që ndodhen. Aldent disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Të gjitha të dhënat e studentëve dhe dokumentacioni i tyre, që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, dhe këto administrohen nga sekretaria mësimore e IAL. Studentët disponojnë portalin e dedikuar për ta në të cilin marrin informacion për gjithë programin që ndjekin. FxEducation është një platformë ku kordinohen të dhënat e sekretarisë mësimore, stafit akademik dhe studentëve me akses të caktuar ndaj informacioneve të nevojshme. [Evd. 12.4, 20.2].
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Të gjitha të dhënat dhe dokumentacioni i stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, administrohen nga zyra e Burimeve Njerëzore në IAL. Dokumentacioni arshivohet dhe ruhet në arkivën e IAL. Për këtë qëllim në dispozicion është edhe platforma FxEducation. [Evd. 20].
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit online FxEducation siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. [Evd. 12.3].
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe	Përvec FxEducation, stafi akademik ka hapësirën e dedikuar në e-learning ku komunikojnë me studentët, publikojnë materiale të moduleve, linke sikurse kontrollojnë projektet e caktuara sipas afatit të paracaktuar. [Evd. 20].



shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.									
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Bazuar në DVV, faqja e Web jep gjithë informacionin e detajuar për programin e studimit, stafin akademik përgjegjës, aktivitete etj. Faqja e ëeb është e publikuar në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. [Evd. 20.2 web. UAL:ual.edu.al].								
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht pasi garantohet sistemi i brendshëm i menaxhimit institucional dhe është në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e	Bazuar në DVV UAL ka hartuar një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

48

<p>studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në këtë plan janë parashikuar kostat infrastrukturore dhe akademike, si dhe të gjitha shpenzimet për mbarëvajtjen e procesit mësimor. [Evd. 14.2].</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit përmban financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit. Ky plan sigurohet nga zyra e financave.</p> <p>[Evd. 2, 113].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar ne DVVnë përfundim të viti kalendarik hartohen pasqyrat financiare të cilat tregojnë gjendjen e biznesit dhe masës së realizimit të tyre nisur nga projekt-buxheti i përcaktuar. Përpilimi i buxhetit në UAL i nënshtohet të gjitha detyrimeve financiare për cdo biznes ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) pasqyra e Pozicionit Financiar; b) Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve; c) Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Financiare; d) Pasqyra e ndryshimit të kapitalit Neto; [Evd. 14.2]
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e</p>	<p>UAL në raportin vjetor financiar paraqet të dhëna mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës për çdo njësisë bazë</p>



njesisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	përgjegjëse për programin. Në përfundim të vitit, njësitë bazë dhe ato kryesore marrin dijeni mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës dhe planifikimin e buxhetit për vitin pasardhës [Evd. 113].			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Në UAL garantohej qëndrueshmëri e vazhdueshme financiare por GVJ gjykon se më shumë mbështetje ekonomike i duhet dedikuar stafit për avancim në tituj sikurse edhe studentëve më pjesëmarrje në konferenca të ndryshme ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit.			
<i>Konkluzione</i>	<i>GVJ mendon se UAL ka një raport financiar të qëndrueshëm dhe mbështet ekonomikisht stafin për rritjen akademike dhe studentët për kërkimin shkencor, por duhet të investohet edhe me shumë me mbështetje financiare për studentet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nsë DVV studentët pranohen në UAL mbështetur në kriteret e pranimit të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe nga vetë UAL. Në rregulloren e Institucionit janë përcaktuar procedurat dhe kriteret e pranimit. Kriteret e vendosura nga IAL rishikohen cdo vit me qëllim rritjen e cilësisë së studentëve në hyrje të programit në përfundim të ciklit të dytë të studimit në programin e intergruar master i Shkencave në Farmaci në të cilin cdo student fiton 300 ECTS si dhe gjuha e huaj e mbrojtur konform kriterëve në fuqi. [Evd. 3, 6.1].</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në DVV, GVJ edhe gjatë takimeve kosntatoi se në UAL rregullorja e programit të studimit përshkruan procesin e aplikimit me kriteret në fuqi. Barazi për të gjithë studentët dhe plotësim të kriterëve parashtrihen në këtë rregullore. Në cdo fillim viti akademik njësia bazë propozon kriteret ose rikonfirmon ekzistueset për vitin akademik të cilat ja përcjell Senatit Akademik i cili i miraton. Kjo paqyrohet e detajuar edhe kontratën tip që cdo student ka me UAL [Evd. 27]. Universiteti nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek, garanton barazinë dhe të drejtën për të gjithë kandidatët për student në të gjitha programet e ofruara.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet e ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë në UAL bëhet në përputhje me kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes, të miratuara nga Senati Akademik para fillimit të vitit akademik. Departamenti merr pjesë në hartimin përpara çdo viti akademik të kriterëve të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të aksesueshme, pasi gjenden në faqen e web-it të UAL, si dhe në Rregulloren e përgjithshme të tij.</p> <p>Në programet e ciklit të parë dhe ato integruara të ciklit të dytë, kriteri i përgjithshëm i pranimit është nota mesatare e shkollës së mesme e përcaktuar me VKM. Kandidati duhet të këtë</p>




diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	përfunduar arsimin e mesëm në brenda ose jashtë vendit. Diploma e arsimit të mesëm, e marrë në një shtet të huaj duhet të jetë e njohur nga struktura përkatëse e MAS. Politikat e pranimit të studentëve parashikohen edhe në programin e studimit [Evd. 12.4, 12.6].
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	UAL para cdo fillim viti akademik realizon vizita në shkollat e mesme ku maturantë informohen për programet e studimit, kriteret e hyrjes dhe tarifata e studimit. IAL informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit në faqen e web-it. [Evd.22.2, 22.3, 22.4].
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UAL parashikon kriteret të veçanta dhe procedura financiare lehtësuese për kandidatët me aftësi të veçanta apo të shtresave të marginalizuara (komuniteti rom dhe egjiptian). Infrastruktura e re është e dedikuar dhe lehtësuese për njerëzit më aftësi të kufizuara fizike. [Evd. 14.3]
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	UAL në rregulloren e programit ka parashikuar kriteret për pranimin e studentëve të nga trojet Shqipëtare por evidenca për studente të huaj që ndjekin programet e UAL mungon. Në kohën ku ndërkombëtarizimi i universiteteve në Shqipëri është kryefjala më shumë duhet të bëjë UAL në këtë drejtim.
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Për këtë kategori janë paracaktuar kriteret për përfitimin e bursave deri në masën 100% ku mbështetja financiare sigurohet edhe nga homologë të huaj. [Evd. 20.2].
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se në UAL ndiqen politika dhe zbatohen procedura duke u bazuar në kriteret ligjore në fuqi për pranimin e studentëve në institucion. Në barazi dhe drejtë e barabartë për dije është hartuar rregullorja e iniversitetit në UAL ka politika për të nxitur përvetësimin e dijeve, në të cilën studentët ekselentë përfitojnë bursa studimi.</i>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Gjatë vizitës me studentët në UAL si dhe në DVV prezantohen që në fillim me informacion e nevojshëm për mbarëvatje të suksesshme të programit që ndjekin, si të drejtat dhe detyrimet, syllabuset, frekuentimi menyra e vlerësimit etj. Gjithashtu, organizmat e këshillave studentorë shërbejnë për informimin e studentëve apo adresimin e problematikave të tyre në organet përkatëse.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstatoi ne DVV si edhe gjatë vizitës në Institucion se studentët informohen në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme bazuar në procedurën e ekuivalentim -transferimit të IAL [Evd. 12.1.1] Regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara sipas udhëzimeve në fuqi.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në lidhje me mënyrën e vlerësimit studentët informohen bazuar në atë cka është e përcaktuar në syllabus të cdo moduli, i cili u vihet në dispozicion në orën e parë të çdo lënde për peshën e secilit komponent vlerësimi, rregullore dhe mbarëvajtje provimi. [Evd. 28]
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe	Në UAL janë të parashikuar në rregulloret e diplomimit të studentëve, procedura dhe mënyra e punimit të temës me kriteret e detyrueshme për përmbushjen e saj. UAL publikon informacione në lidhje me mënyrën e punimit të tezës së diplomimit, duke përfshirë jo vetëm formatin e shkrimit por edhe udhëzime në lidhje me organizimin e përgjithshëm të saj Studenti plotëson me dëshirën e tij fushën ku ai dëshiron të




diplomimit në programin e studimit.	punojë temën e diplomës dhe në mbledhjen e njësisë bazë caktohet udhëheqësi i cili i përshtatet fushës së përzgjedhur nga studenti. Temat miratohen nga Dekani i Fakultetit dhe dorëzohen disa javë para mbrojtjes së tyre. [Evd. 31:1, 31:2, 31:3]			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Zyra e Zhvillimit të Karrierës në UAL organizon takime me maturantët për programet e studimit të UAL-it, shpërndan postera, përgjigjet për pyetjet që kanë të interesuarit. Spoteve publicitare janë gjithashtu një praktikë që UAL ndjek. [Evd. 24:3, 24:4]			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se ky standart përmbushet plotësisht, pasi në UAL ka kritere dhe procedura të percaktuara në Rregullore e IAL për diplomimin, natyrën e përzgjedhjes së teës si dhe modalitetet e vlerësimit të saj. Zyra e Zhvillimit të Karrierës në UAL luan një rol të rëndësishëm në promovimin e dhe informimin e maturantëve për programin e studimit. Zhvillimit të Karrierës në UAL</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standarti V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstatoi se në UAL studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ndryshimet eventuale në programin e studimit. Kjo mundësohet nga bashkërendimi i veprimtarisë së tutoriatit me pedagogët e lëndëve dhe moduleve me të cilët studentët marrin informacionin në fillim të viti akademik, ndërsa me tutoriatin gjatë gjithë viti akademik. [Evd. 12.6, 20.2]

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë


Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

web site: www.ascal.al

54


<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Përveç syllabuseve të lëndëve/moduleve që u vihen në dispozicion studentëve nga pedagogët përkatës, ata informohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmejt portalit të studentit për literaturën dhe materiale të tjera që mund të shfrytëzohen në funksion të modulit, studentët informohen për literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar. [Evd. 28]</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët informohen për çdo aspekt për të cilin ata janë të interesuar si p.sh mbi mundësitë e mobilitetit nëpërmjet programeve të ndryshme, punësimin si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. ZKK në bashkëpunim me ALUMNI-n hartojnë periodikisht raporte në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar në UAL. [Evd. 24.1, 7].</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Bazuar në DVV, orientimi dhe këshillimi i studentëve realizohet dhe nëpërmjet guidave informative, individuale fizike sikurse edhe ato të cilat janë të publikuara në formë dixhitale.</p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe gjatë takimeve u konfirmua se informacioni mundësohej nëpërmjet portal të studentit në faqen zyrtare të web-it jep informacion për studenët panvarësisht vendodhjes së tyre fizike në institucion ose jo. Në nivel programi studimi është ngritur dhe funksionon tutoriati ku për çdo kurs studimi është caktuar një pedagog i departamentit për t'i asistuar studentët në problematika të ndryshme por dhe për ti informuar në lidhje me aktet rregullative dhe elemente të detajuar të programit të studimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se ky standart përmbushet plotësisht. Orientimi dhe këshillimi i studentëve realizohet dhe nëpërmjet guidave informative, individuale fizike sikurse edhe ato të cilat janë të publikuara në formë dixhitale.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																								
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në insitucion konstatoi se sekretaria dhe arkiva mbajnë regjistrin e diplomave të lëshuara, ruajnë në formë të printuar, elektronike ose edhe në regjistra të plotësuar me dorë në zyrat e sekretarive mësimore të secilit Fakultet evidenca nga fillimi i programit deri ne përfundim. [Evd. 17, tabela 21, 23]</p>																								
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Bazuar ne DVV dhe gjate vizitës ne UAL, të dhënat përpunohen në mënyrë statistikore nga akriyat që sekretaritia arkivon. Sekretaria mban regjistrin e regjistrimeve për çdo program studimi, regjistrin e diplomave të lëshuara, dosje personale të studentëve, dokumentacion të procedurave të transferimit apo çregjistrimit, procesverbale të provimeve, urdhra, udhëzime të ministrisë apo të organeve drejtuese të universitetit, etj. [Evd. 12.3]</p> <p>Referuar vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të rregjistruar në këtë program studimi për pesë vitet akademike ishte:</p> <table border="1" data-bbox="598 1193 1394 1585"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Të cregjistruar</th> <th>Total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>68</td> <td>4</td> <td>64</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>60</td> <td>9</td> <td>51</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>81</td> <td>13</td> <td>68</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>102</td> <td>13</td> <td>89</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>86</td> <td>2</td> <td>84</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Të regjistruar	Të cregjistruar	Total	2018-2019	68	4	64	2019-2020	60	9	51	2020-2021	81	13	68	2021-2022	102	13	89	2022-2023	86	2	84
Viti akademik	Të regjistruar	Të cregjistruar	Total																						
2018-2019	68	4	64																						
2019-2020	60	9	51																						
2020-2021	81	13	68																						
2021-2022	102	13	89																						
2022-2023	86	2	84																						
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të gjitha të dhënat e studentëve administrohen nga sekretaria mësimore e UAL. [Evd.13, 14, 62, 63, 64, 103].</p>																								



të verifikueshme nga personat e autorizuar.									
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e universitetit dhe të arkivës. I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet në databazën e sistemit të brendshëm. Për dokumente zyrtare, si procesverbale notash, vërtetime, ato gjenerohen vetëm nga persona të autorizuar dhe në një periudhë të caktuar kohe. Më pas këto dokumente janë unike dhe të patjetërsueshme.								
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ konstaton se departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Karrierës harton raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe shkallën së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. [Evd. 17]								
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se ky standart përmbushet plotësisht, pasi veprimtaria e njësisë bazë ishte e mirëdokumentuar nga sekretaria mësimore, nga sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit, ku saktësia e informacionit lidhur më studentët dhe veprimtarinë e tyre ishte koherente.</i> <i>ZKK hartonte raporte periodike analitike rreth punësimit të studentëve dh masave që duhen marë për përmirësimin e treguesve të tregut</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Përfaqësimi i studentëve në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe administrimit të UAL është garantuar në Statut dhe aktet rregullatorë të institucionit dhe fakulteteve. Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale të universitetit, siç janë Senati Akademik dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në komisionet ad-hoc të ngritura në kuadër të vlerësimeve dhe analizave në nivel institucional dhe programi [Evd.4].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët përfshien në proceste vendimmarrëse në UAL nëpërmjet vlerësimeve të tyre në pyetsorin e studentëve për procesin akademik, në të cilin medimet apo sugjeimet merren në konsideratë nga njësia bazë dhe reflektohen në ëpërmirësimin e silabuseve, në përmirësimin e metodave të mësimdhënies, si dhe ndryshimet kurrikulare. [Evd. 12.5, 21.3]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Ndër strukturat pjesë e UAL në përmirësimin e programit të studimit janë edhe <i>Studentët aktualë</i> në programin e studimit, të cilët japin mendimin dhe propozimin e tyre për programin e studimit.</p> <p>Ata janë të organizuar me përfaqësuesit e tyre “senator” në nivel kursi por edhe në nivel programi studimi të cilët nëpërmjet Këshillit Studentor përcjellin. Mendimet dhe sugjerimet e tyre.[Evd. 12.5].</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe</p>	<p>Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit për metodat e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. UAL ka të përcaktuar qartë edhe në rregulloren e programit të studimit modalitetet e këtij</p>

ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	procesi, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës të lëndës/modulit.			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se ky standart përmbushet plotësisht pasi në UAL studentët janë të përfshirë në organet kolegjiale dhe të drejtat e tyre janë të shprehura në statut dhe rregulore të UAL. Studentët luajnë një rol aktiv në përmirësimin e procesit të mësidhënies, kurrikulës dhe janë të përfshirë në vendimarrje.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UAL ka zyrën e këshillimit të karrierës dhe ALUMNI-t e cila është në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Veprimtaria e zyrës së këshillimit të karrierës orjentohe drejtë informimit të studentëve dhe këshillimit të tyre që në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre ofron, mundësitë e punësimit në të ardhmen, etj. [Evd. 12.6].
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin	Zyra e Këshillimit të Karrierës përmbush këtë kriter, ajo përditëson studentët me informacion të hollësishëm mbi mundësitë e pjesëmarrjes në trajnime profesionale, forume rinore, aplikimet e mundëshme në konferencat vendase, rajonale dhe ndërkombëtare, etj. [Evd.24.1].

mësimor dhe programin e studimit.									
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. [Evd.7].	Zyra për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. [Evd.7].								
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Karrierës dhe Alumni ndihmon studentët të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes, për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës. Zyra mban rregullisht të dhëna rreth shkallës së punësimit të studentëve sipas degëve e viteve të tyre të diplomimit. [Evd.24.1, 7]								
Konkluzione	<i>GVJ mendon që ky standart është përmbushur plotësisht. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI është në shërbim të informimit të studentëve jo vetëm gjatë procesit akademik për veprimtari akademike por edhe për dhënie informacioni për tregun e punës bazuar në të dhënat e grumbulluara ndër vite.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UAL harton udhëzues në nivel institucional për përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies si manuali i zhvillimit të mësimin online për shkak të pandemisë COVID-19, tutoriale online të demonstrimit të praktikave laboratorike, sikurse dhe mënyra takimi virtual për diskutime dhe konsultime.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	UAL ka të konsoliduar Njësinë e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë sipas udhëzimeve të MAS, dhe sipas të cilave synon të sigurojë përmirësimin në mënyrë të vazhdueshme si një IAL. NJSBC në përfundim të vitit akademik harton raportin vjetor së bashku me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti i NJSBC-së hartohet bazuar në anketimet e vazhdueshme të studentëve dhe në rezultatet e monitorimit të kryera nga Njësia gjatë vitit akademik. Rezultatet reflektohen edhe në formularin e performancës akademike. [Evd. 21.1, 22.4.1].
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Bazuar në DVV UAL garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, nëpërmjet anketimeve dhe pyetësorëve që plotësohen nga studentët në mënyrë anonime. Cdo vit nga NJSBC përfshihen nëpërmjet pyetësorit elektronik të gjithë studentët të cilët shprehin mendimet e tyre në mënyrë të lirë dhe vullnetare [Evd. 21.3]




Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Të dhënat e pyetësorëve pasi përpunohen dhe analizohen, konkludohet me raportin e NJSBC, i cili është publik dhe i aksesueshëm në faqen ëeb të UAL [Evd. 21.1.1].			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar ne DVV, UAL nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra kryesisht pyetsorëve, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin pikave të dobëta të evidentuara. [Evd.21.1]			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se ky standart përmbushet plotësisht pasi NJSBC në UAL ushtron veprimtarinë e bazuar në rregulloren e kësaj njësie ku në fokus është përmirësimi i mësidhënies dhe mësimnxënies, duke përdorur mekanizma nxitës përmirësues të këtij procesi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në DVV, UAL ndjek normat ligjore në fuqi, rregulloren e përgjithshme dhe statutin e universitetit për të siguruar instrumentat e nevojshme për sigurimin e cilësisë. Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e tij përgjegjësinë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, programeve të studimit dhe aspekteve të veçanta të mësimdhënies e mësimnxënies, e mbështetur kjo në nenin 13 të Statutit dhe në Rregulloren e Përgjithshme të UAL [Evd. 6.1]
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion	




<p>Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar ne DVV dhe në takimin me stafin e NJSBC, kjo njësi është organi kryesor i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe bashkëpunon me përfaqësuesit e saj në çdo njësi kryesore. Veprimtaria e saj bazohet në Ligjin e Arsimit të Lartë, në statutin e UAL si dhe në standardet dhe Udhëzimet shtetërore dhe udhëzimet për vlerësimin e jashtëm nga ASCAL.</p> <p>Të gjithë analizat /raportet/të dhënat e dala nga procese vlerësimi janë pjesë e raporteve vjetore në nivel departamenti / fakulteti / universiteti, duke evidentuar problematika sipas aspekteve dhe adresuar ato për zgjidhje, proces ky i vazhdueshëm lidhur me përmirësimin e cilësisë. [Evd. 6.1].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar ne DVV, Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë sikundër është përcaktuar në Kodin e cilësisë dhe Manualin e vlerësimit të jashtëm të hartuar nga agjencia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë ASCAL.</p> <p><i>GVJ konstatoi se nuk kishte një procedure sesi keto standarde të reja zbatoheshin.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Politikat, procedurat për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në programet e studimit që ofron UAL, janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e NJSBC dhe në aktet rregullative të institucionit.</p> <p>UAL inkurajon pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve në konferenca të organizuara nga UAL por edhe të tjera. Mbi bazë të tresuesve të performancës UAL bën promovime nxitëse përmes mbështetjes financiare të këtyre aktiviteteve.</p> <p>[Evd. 14, 15]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se ky standart përmbushet plotësisht pasi kontrolli i cilësisë në UAL realizohet nga NJSBC bazuar në aktet ligjore</i></p>




	<i>në fuqi dhe nga aktet normative të vetë UAL. Implemetimi i tyre duhet të shoqërohet më një procedure standard pune.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe gjatë takimeve ne insitucion GVJ kostatoi se UAL ka krijuar mekanizma të nevojshme dhe instrumenta matëse për vlerësimin periodik të programeve të studimit. Drejtuesi i njësive kryesore dhe bazë së bashku me atë të NJSBC mbikëqyrin veprimatrinë emësidhënies dhe zbatimin e rregulloreve.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit është personi përgjegjës i cili ndjek dhe monitoron ecurinë e programit të studimit. Raportimet periodike, diskutimet në departamente dhe Dekanat, janë pjesë e proceseve të vazhdueshme që zhvillohen për garantimin e ecurisë së programit. GVJ kostatoi se mungon koordinatori i programit. Ndërkohë, në analizën vjetore të njësive bazë dhe fakultetit, ecuria e programeve në tërësi analizohet dhe jepen të dhëna në formë përshkrimore dhe sasiore për aspekte të ndryshme të ofrimit të tyre. Rezultatet e vlerësimit NJSBC ja përcjell rektorit i cili ja komunikon Senatit që merr vendim për përmirësimin e tyre. [Evd.21.1]</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më</p>	<p>Bazuar ne DVV, NJSBC cdo fudnviti akdemik publikon raportin vjetor. Pjesë të këtij raporti janë përmbledhje për personelin akademik të angazhuar në program, përditësimi i literaturës së programit, rezultatet e studentëve (kalueshmëria dhe nota mesatare), marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore</p>

<p>të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>shkencore, infrastruktura në funksion të programit, duke e përmbyllur raportin me analizën përfundimtare dhe plan masash për përmirësim. Në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, në përfundim të çdo viti akademik, Drejtoria e Kurrikulave nis procesin e përditësimit të programeve në nivel institucional me qëllim rritjen e cilësisë në përmbajtje të tyre. [Evd 20.2]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UAL në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve.</p> <p>Departamenti, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor mënyra të tjera vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (ALUMNI), të personelit akademik, ndihmës-akademik, drejtuesit e farmacive që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p> <p>[Evd. 20.2, 21.2, 21.1.1].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës-akademik e administrativ, punëdhënësit</p>	<p>Bazuar në DVV, UAL, zbaton edhe metodika të tërthorta të vlerësimit të cilësisë si Pyetsorët e Studentëve dhe të personelit akademik. Gjatë vizitës në AUL u rikofirmua në metodat tërthorta edhe informacioni që merret nga sistemi I tutoriatit dhe ku një ndër to është edhe intervistimi i studentëve të për procesin mësimor. Një indikator është edhe informacioni i marë nga personeli i përfshirë në mbikëqyrjen e praktikave profesionale mësimore [Evd. 21.2.21.3]</p>

e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.				
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se ky standart përmbushet plotësisht, pasi në UAL përdoret rregullore dhe procedura të cilat kontrollojnë cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe eksizojnë mundësi për përmirësimin e tyre në sajë të procedurave përkatëse. Metodat e drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta, rrisin kontrollin e cilësisë dhe ndihmojnë në përmirësimin e kritereve që studentët të fitojnë kompetecat e duhura në programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UAL nëpërmjet NJSBC garanton cilësinë dhe përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në përbërje të NJSBC ka nga një anëtarë nga cdo fakultet i UAL, një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga këshilli studentor. Në këtë proces përfshihen edhe faktorë të tjerë vlerësues si tutorët ,s sekretaria mësimore, personi akademik , drejtues departamenti etj [Evd. 17, Tabela 24].

<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Vlerësimi i programeve të studimit dhe personelit akademik bazohet në kriteret e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësim nga njësia kryesore mbi bazën e raportit të hartuar nga njësia bazë në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, si dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen. ▪ Vlerësimi nga drejtuesi i departamentit – çdo fund viti drejtuesi i departamentit, harton një raport përmbledhës për secilin pedagog, në të cilin konsiderohen: vlerësimi mesatar i marrë nga pyetësorët drejtuar studentëve, vlerësimi mbi korrektësinë e realizimit të orëve të mësimi përmes raportit semestral të hartuar nga pedagogët.
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal. Gjithashtu, GVJ konstatoi <i>pasi nuk pasyrohët roli i NJBSC në përditësimin e silabuseve dhe masat e veprimit të mara për ato raste kur evidentohen probleme.</i></p> <p>[Evd. 21.1].</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>NJSBC bashkëpunon me departamentet si njësi bazë. Në përzgjedhjen e anëtarëve në proceset ciklike të vlerësimit janë patur parasysh kompetencat profesionale, vlerësimi i paanshëm dhe objektiv, aftësitë analitike, shkalla e njohjes së institucionit dhe veprimtarive të tij, si dhe eksperiencia të mëparshme në veprimtari të ngjashme vlerësuese.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të</p>	<p>Bazuar në DVV, NJSBC në përbërje të saj ka një ekspert të jashtëm, i cili jep kontribut në hartimin e pyetësorëve dhe</p>



cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	përpunimin e raporteve të kësaj strukture. Detyrat e anëtarëve të saj janë të shprehura në rreguloren e NJSBC. [Evd. 21.1]						
Konkluzione	<i>GVJ kostatoi se ky standart përmbushet kryesisht, pasi nuk pasyrohet roli i NJBSC në përditësimin e silabuseve dhe masat e veprimit të mara për ato raste kur evidentohen probleme</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit			<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="987 716 1177 808">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1185 716 1394 808">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="987 813 1177 866" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1185 813 1394 866"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X	
Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
X							

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	IAL publikon në faqen zyrtare të web procedurat që institucioni kryen në kuadër të sigurimit të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit dhe njëkohësisht inkurajon që stafi dhe studentët të përfshihen në mekanizmat e sigurimit të cilësisë në universitet. [Evd.21.1.1].
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	IAL në përfundim të çdo viti akademik publikon raportin vjetor të cilësisë, i cili hartohet nga struktura e NJSBC brenda institucionit. Ky raport përfshihet edhe në raportin vjetor të aktiviteteve të IAL [Evd.21.1.1].

Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Sipas NJSBC ne UAL, procesi i vlerësimi shoqërohet me gjetje dhe detyra për njësitë /strukturat përkatëse, duke hartuar edhe plani i masave për përmbushjen e detyrimeve të caktuara [Evd. 21.1.1]			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar ne DVV, GVJ konstatoi se Senati akademik ndërmerr masat që gjykon dhe kuadër të përmirësimin të cilësisë dhe ka autoritet për të monitoruar zbatimin e tyre, por këto masa nuk shoqërohen qartë se ku bazohen si dhe mungojnë evidencat mbështetëse për këtë konfirmim.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Takime periodike kryhen edhe me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në organet kolegjiale të institucionit me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Përfaqësues i NJSBC, shërbimi i tutoriatit akademik dhe zyra e zhvillimit të karrierës si dhe përgjegjësit e programeve luajnë një rol të rëndësishëm. Në sigurimin e cilësisë në programin mësimorë[Evd. 19].			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi qe ky standard përmbushet plotësisht NJSBC e ushtron veprimtarine e saj në pëputhje me aktet normative te IAL Ligjit të Arsimit të Lartë, si dhe standardeteve shtetërore për arsimin e lartë në vend</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Integruar i Shkencave në "Farmaci"

a. Pikat e forta dhe afirmime:


1. Staf akademik dhe administrativ i kualifikuar në mbështetje të menaxhimit dhe realizimit të programit "Master i Shkencave" në "Farmaci";
2. Infrastrukturë bashkëkohore në përputhje me standardet përkatëse të cilësisë në funksion të mbarëvajtjes të programit të studimit "Master i Shkencave" në Farmaci;
3. Politika dhe strategji për bashkëpunime me sektorin farmaceutik për realizimin e praktikave në terren dhe punësim pas përfundimit të programit;
4. Marrëveshje të shumta me institucione të tjera vendase dhe të huaja për shkëmbim të studentëve dhe stafit;

b. Pika të dobëta:

1. Angazhimi në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi edhe të stafit akademik me Msc, në një përqindje të ulët, në kundërshtim me parashikimet në nenin 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet niveli i kualifikimit akademik; (*Standarti IV.1, Kriteri 1*)
2. Mungesë e aplikimeve për projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare, me partner vendas dhe të huaj me bazë eksperimentale për këtë program studimi: (*Standarti IV.1, Kriteri 7*)

Rekomandime

1. Rekomandohet të meren masat e nevojshme për të mundësuar që personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në realizimin e programit të studimit të ketë të paktën gradën shkencore Dr., në mënyrë që të përmbushen kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik;
2. Rekomandohet të ndërmerren politika dhe strategji për rritjen e financimit të aktivitetit kërkimor dhe shkencor nga UAL, por edhe burimeve alternative të financimit (pjesëmarrje në shkrim dhe propozim projektesh për fonde kombëtare dhe ndërkombëtare);
3. Rekomandohet të ndërmerren politika dhe strategji për të arritur një raport optimal midis ngarkesës mësimore të personelit akademik dhe pozicioneve akademike apo në përputhje me pozicionet akademike dhe administrative të tyre;



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Integrated Master of Sciences "Pharmacy"

a. Strengths and Affirmations:


1. Qualified academic and administrative staff to support the management of the Master of Science in Pharmacy program;
2. Modern facilities and infrastructure for the successful implementation of a Master of Science in Pharmacy curriculum;
3. Close ties with the private sector (pharmacies) for field practices and employment opportunities upon program completion;
4. Collaboration with other national and international institutions for student and staff exchange programs;

b. Weaknesses:

1. The engagement in the teaching process in this study program of the academic staff with Msc, even in a low percentage, contrary to the provisions in article 59/6 of Law no. 80/2015 where the level of academic qualification is determined; *(Standard IV.1, Criterion 1)*
2. Lack of applications for joint national and international projects, with local and foreign partners, with experimental research for this study program: *(Standard IV.1, Criterion 7)*

Recommendations:

1. It is recommended to take necessary measures to enable effective academic staff with contracts engaged in the implementation of the study program to have at least a PhD degree, in order to meet the current legal requirements for the appropriate level of academic qualification;
2. It is recommended to undertake policies and strategies to increase funding for research and scientific activities from UAL, as well as alternative sources of funding (participation in writing and proposing projects for national and international funds);
3. It is recommended to undertake policies and strategies to achieve an optimal ratio between the teaching workload of academic staff and their academic or administrative positions, or in accordance with their academic and administrative positions;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI i PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI i PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI i CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X